



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:116035
Datë: 18.03.2024
Numri i dokumentit: 05464954

C.nr.2770/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Përparim Zeka, në çështjen juridike kontestimore të paditëses N. S. nga Prishtina, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson avokat N. A. nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensim i pagës mbi bazën e inflacionit, shujtave ditore dhe transportit, jashtë seancës, me datë 18.03.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses N. S. nga Prishtina dhe DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit në Prishtinë, që paditëses në emër të kompensimit për inflacion për periudhën kohore prej 01.01.2019 deri në 31.12.2022, gjithsej për 48 muaj, t’ia paguaj shumën prej 987.90 €, në emër të kompensimit për ushqim gjatë punës për periudhën kohore prej 02.03.2021 deri në 31.12.2022, gjithsej për 327 ditë pune, shumën në lartësi prej 654.00 €, si dhe kompensimin e 70% të shpenzimeve të udhëtimit, për periudhën kohore prej 02.03.2021 e deri më datën 31.12.2022 respektivisht 327 dite të udhëtimit, ti paguaj shumën prej 366.22 €, apo në shumën e përgjithshme 2,008.12€.

II.DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses t’ia paguaj kamatën në lartësi prej 8%, nga data e ushtrimit të padisë datë 07.06.2022 deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 124.00€, e të gjitha në afat prej 7 ditësh nga marrjes së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Paditësja përmes të autorizuarit të saj, pranë kësaj gjykate, me datë 07.06.2022, ka parashtruar padi kundër të paditurës, me objekt kontesti kompensim e pagave mbi bazën e inflacionit, shujtave ditore dhe udhëtimit (transportit). Në padi dhe në precizimin e datës 27.06.2023 ka theksuar se paditësja është e punësuar tek e paditura në SHMT “28 Nëntori” në Prishtinë. Ka shtuar se paditësja i plotësoj kushtet për përfitimin e kompensimit në pagë mbi bazën e inflacionit vjetor, kompensimin e ushqimit dhe kompensimin e udhëtimit, e drejt kjo e garantuar sipas Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës neni 35 par. 5, 7 dhe 10. Tutje ka shtuar se paditëses nuk i’u është bërë kompensimi në pagë mbi bazën e inflacionit vjetor, shpenzimeve të ushqimit dhe shpenzimeve të udhëtimit dhe atë, për periudhën kohore prej 01.01.2019 deri në 31.12.2022 në emër të inflacionit, gjithsej për 48 muaj, t’ia paguaj shumën prej 987.95 €, në emër të kompensimit për ushqim nga data 02.03.2021 deri në 31.12.2022, gjithsej për 327 ditë prezentë në punë në shumën prej 654.00, si dhe në emër të shpenzimeve të udhëtimit nga data 02.03.2021 deri në 31.12.2022, gjithsej për 327 ditë të udhëtimit, t’ia paguaj 70% të biletës së udhëtimit në shumën prej 366.22€, me kamatë ligjore 8% nga data e paraqitjes

së padisë e deri në pagesën definitive, duke kërkuar nga gjykata që të aprovohet në tërësi kërkesëpadia si e bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura në përgjigjen në padi ka theksuar se e konteston në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve, për arsye se një kompensim i tillë nuk është paraparë as me Ligjin e Punës nr.03/L-212. Po ashtu ka shtuar se, në rastin konkret ekziston parashkrimi i kërkesës pasi që konform dispozitave të LMD-së, pagesat mujore qoftë nga marrëdhënia e punës apo kompensime tjera mujore parashkruhen brenda afatit 3 vjeçar. Tutje ka theksuar se e paditura gjatë përgatitjes së buxhetit nuk ka paraparë në skemën e saj buxhetore, linje të veçantë buxhetore për këto lloje të kompensimeve. Prandaj, ka kërkuar nga gjykata pas administrimit të provave kërkesëpadinë e paditësës ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Lidhur me shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e provave të bashkangjitura padisë, si dhe pas pranimit të përgjigjes në padi, mbështetur në nenin 8 dhe 398 të LPK-së, ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, por se e paditura ka ngritur çështje që kanë të bëjnë me pamundësinë e përmbushjes së detyrimit. Në këtë rast kontestues është vlerësuar se nuk ka pengesa në kuptim të dhënies së vendimit meritor jashtë seance.

Nga provat e bashkangjitura padisë gjykata gjeti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, sipas kontratës të datës 02.07.2015.

Gjykata përmes vërtetimeve mbi ditët e prezencës në punë gjeti paditësja sipas vërtetimeve të datës 29.04.2022 dhe 13.03.2023 për periudhën kohore 02.03.2021 e deri me datën 31.12.2022 ka 327 ditë prezentë në punë. Nga vërtetimi i datës 05.05.2022 vërtetohet se paditësja ka vendbanimin në Prishtinë në rrugën "...", e njëjta ka udhëtuar me trafikun urban. Kjo e vërtetuar edhe nga kuponi fiskal me nr. fiskal 811289009 i datës 06.05.2022.

Nga provat e administruara si më lartë, gjykata gjeti se paditësja nuk ka pranuar kompensimin në pagë në emër të inflacionit vjetor, shpenzimeve të ushqimit dhe shpenzimeve të transportit, në kohën sa ka qenë në fuqi KKAK.

Nga vërtetimi i gjendjes faktike, vërehet se paditësja në emër të kompensimit për inflacion i takon shuma e përgjithshme prej 987.90€, pasi që shkalla e inflacionit për periudhën 01.01.2019 deri 31.12.2019 ka qenë 2.7%, andaj ka llogaritur pagën bazë të paditësës (paga 459.95 x 2.7%=12.41€) shumëzuar për 12 muaj përfitohet shuma 149.02€, për periudhën kohore 01.01.2020 deri 31.12.2020 ka qenë 0.2% andaj ka llogaritur pagën bazë të paditësës (paga 459.95€ x 0.2%=0.91€) shumëzuar për 12 muaj përfitohet shuma 11.03€, për periudhën kohore 01.01.2021 deri 31.12.2021 ka qenë 3.4% andaj ka llogaritur pagën bazë të paditësës (paga 459.95€ x 3.4%=15.63€) shumëzuar për 12 muaj përfitohet shuma 187.65€, për periudhën kohore 01.01.2022 deri 30.12.2021 ka qenë 11.6% andaj ka llogaritur pagën bazë të paditësës (paga 459.95€ x 11.6%=53.35€) shumëzuar për 12 muaj përfitohet shuma 640.25€. Këtë lloj kompensimi gjykata i'a njohte paditësës në harmoni me nenin 35 par.10, të KKAK-së, ku është paraparë se: "Për çdo vite të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë".

Në padi është ngritur pretendim se paditësja nuk ka pranuar kompensimin në emër të ushqimit për ditët e kaluara në punë, në kohën sa ka qenë në fuqi KKAK. Nga vërtetimi i gjendjes faktike lidhur me këtë pjesë të kërkesëpadisë, vërehet se paditësja ka 327 ditë prezence në punë, prandaj gjykata ditët e kaluara në punë të paditëses i ka shumëzuar 2€, rrjedhimisht duke u'a njohur shumat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Këtë lloj kompensimi gjykata i'a njohu paditëses në harmoni me nenin 35 par.7, të KKAK-së: "Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqime gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2(dy) euro për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore".

Po ashtu nga provat e administruara si më lartë, gjykata gjeti se paditësja nuk ka pranuar kompensimin në emër të udhëtimit (transportit) për ditët e kaluara në punë, në kohën sa ka qenë në fuqi KKAK. Nga vërtetimi i gjendjes faktike, është konstatuar se paditësja për periudhën kohore 02.03.2021 e deri më datën 31.12.2022 në emër të kompensimit e shpenzimeve të transporti për 327 dite të udhëtimit, nga 1.60 euro në ditë të vlerës së biletës së udhëtimit vajtjeardhje, t'ia paguaj 70% të vlerës së biletës së udhëtimit në shumen prej 366.22€, rrjedhimisht duke njohur shumën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Këto lloje të kompensimi gjykata i'a njohu paditëses në harmoni me nenin 35 par.5, të KKAK-së ku thuhet se: "punonjësit e arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatës ku punojë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban".

Gjykata duke ju referuar Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës dispozitat e së cilës aplikohen në tërë Republikën e Kosovës, ku në nenin 35 është paraparë e drejta punëtoreve të arsimit në kompensimin e inflacionit në pagë, kompensim në emër të ushqimit dhe kompensim në emër të udhëtimit (transportit), gjeti se e njëjta është e aplikueshme nga hyrja në fuqi me datë 18.04.2017. Pas skadimit të kësaj kontrate, është nxjerrë kontrata e re, e cila i'u garanton punonjësve të arsimit këto të drejta.

Nga të lartcekurat gjykata ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e aktgjykimit aprovues jashtë seance, në kuptim të nenit 398 i LPK-së, sipas të cilit "Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë". Duke qenë se ka lindur e drejta e paditëses për të kërkuar në rrugë gjyqësore realizimin e të drejtës për kompensim në pagë mbi bazën e inflacionit dhe kompensimit të ushqimit, e njëjta është legjitimuar që të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga e paditura, së këndejmi, paditësja e ka rolin e kreditorit kurse e paditura rolin e debitorit. Në kuptim të nenit 245 të Ligjit nr. 04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve: "Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij". Rrjedhimisht, duke qenë se e paditura i ka mbetur borxh paditëses, me aplikimin e dispozitës së lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditëses t'ia kompensoj shumat si në dispozitiv të aktgjykimit.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigje në padi, gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike, sepse e paditura nuk e konteston bazën e kërkesës, e as lartësinë e kërkesës së paditëses, me anë të përgjigjes në padi. Ndërsa çështja e mënyrës së pagesës, respektivisht mundësisë së pagesës nga ana e të paditurës, se për këtë objekt të kërkesë e paditura nuk ka planifikuar buxhet

dhe nuk kanë vijë buxhetore për ta realizuar këtë kompensim, nuk është rrethanë e natyrës juridike që ndikon për te marr vendim ndryshe në këtë rast. Prandaj gjykata erdhi në përfundim se faktet në këtë rast, nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor dhe se pala e paditur është obliguar ta përmbush obligimin ndaj paditëses. Ndërsa lidhur me pretendimet se kemi kërkesë të parashkruar të paditëses gjykata këtë pretendim e ka gjetur si të pa bazuar për faktin se në rastin konkret paditësja ka kërkuar realizimin e kësaj të drejte për vitet 2019, 2020 2021 dhe 2022, sa ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit, ndërsa padinë e ka ushtruar në gjykatë në vitin 2022, rrjedhimisht nuk kemi të bëjë me parashkrim pasi që nuk ka kaluar afatit 3 vjeçar.

Lidhur me lartësinë e kamatës së llogaritur prej 8%, gjykata vendosi në kuptim të nenit 382 të LMD-së, sipas të cilit Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë, e do të llogaritet nga dita e parashtrimit të padisë datë 07.06.2022.

Gjykata vendosi si në dispozitivin e II të këtij aktgjykimi, ashtu që e paditura të paguaj shpenzimet e procedurës në lartësi prej 124.00€, në kuptim të nenit 452 të LPK-së. Lartësia e shpenzimeve i referohet shpenzimeve për përpilimin e padisë në shumë prej 104.00€ - sipas tarifës së OAK dhe taksa gjyqësore në shumë prej 20.00€.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.2770/22, datë 18.03.2024

Gjyqtari
Përparim Zeka

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së te njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.